

GANI PLLANA

**TERMAT E HUAZUAR NGA ITALISHTJA DHE FRËNGJISHTJA NË
TERMINOLOGJINË E MEKANIKËS NË GJUHËN SHQIPE**

1. Hyrje

Shqipja gjatë historisë së saj, ka qenë në kontakt me gjuhë të ndryshme të Gadishullit Ballkanik.

Duke vështruar leksikun e shqipes së sotme, në terminologjitë e fushave të ndryshme të dijes, na shfaqet e gjithë pasuria leksikore, e përbërë prej dy shtresash kryesore: leksiku vendës dhe leksiku i huaj, i futur përmes huazimeve dhe e kalkimeve të ndryshme nga gjuhë të ndryshme, ku vend të rëndësishëm zënë gjuhët e zhvilluara e moderne, sidomos italiane e frënge. Një ndër terminologjitë e shqipes ku spikat ky ndikim është edhe terminologjia e mekanikës, e cila realisht ka një zhvillim të vonë, çka shpjegon edhe faktin e ndikimit të saj nga gjuhët e zhvilluara, duke arritur deri te fjalët e përdorimit të përgjithshëm nga fusha e kulturës dhe sferave të ndryshme të teknikës.

Vihen re një varg ndryshimesh lidhur me historinë, që për ne është shumë e vështirë të rindërtohet plotësisht në gjuhën shqipe. Realisht ka jo vetëm një numër relativisht të madh huazimesh, por ka edhe një varg përkimesh leksikore me gjuhët e lartcekuara.

Duke folur sidomos për ndikimin e terminologjisë italiane të mekanikës mbi shqipen nuk mund të lihet pa përmendur pararendësja e gjuhës italiane, latinishtja, vështruar nga pikëpamja e ndikimit mbi terminologjitë shqipe në tërësi. Kjo ka shumë rëndësi të nënvizohet se shumë terma të mekanikës shihen si huazime të ardhura nga terminologjitë e hershme bazë si matematika, fizika, gjeometria etj., të cilat kanë zhvillim të hershëm. Ndikimi i latinishtes në gjuhën shqipe u ushtrua për një kohë relativisht të gjatë prej disa shekujsh, si gjuhë shtetërore, si gjuhë e marrëdhënieve ekonomike e tregtare, si gjuhë e kulturës, ku elementet latine në leksik zënë vendin e parë midis huazimeve të shqipes nga numri dhe masa e përdorimit të tyre. Latinizmat e shqipes paraqiten në trajta që u takojnë shtresave të ndryshme kohore¹.

Latinizmat i përkasin shtresës së leksikut të përgjithshëm dhe pjesërisht terminologjive të hershme të shqipes. Latinizmat në termat e mekanikës kanë

¹M. Domi, "Probleme të historisë së formimit të gjuhës shqipe", në Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar të gjuhës dhe të kulturës së saj, (Tiranë, 2-5 korrik 1982), Tiranë, 1988, f. 179.

hyrë si të thuash, si latinizma të italianizuara nëpërmjet italishtes. Terminologjia teknike lindi më vonë, në fillim të shekullit XX-të.

Huazimet latine të shqipes janë ngulitur në leksikun e shqipes, sidomos në leksikun e përgjithshëm, me sa duket në një kohë shumë të hershme, saqë del e nevojshme që huazimet latine, të paktën për një kohë të vjetër, të vështrohen jo si huazime, por përkundrazi si “*fjalë latine të hershme*”².

Pjesa e huazimeve latine në shqipe, në leksikun e përgjithshëm, është kaq e madhe, saqë gjuhën shqipe shpesh e kanë cilësuar si një “gjuhë e përzier gjysmëromane”, ku G. Mayer shkruante: “*Është jashtë çdo dyshimi që gjuha shqipe i ka shpëtuar për një qimë romanizimit të plotë, ashtu si keltishtja në Francë. Ajo doli nga kjo periudhë me dëmtime të rënda të tingujve, të fjalorit dhe të formave gramatikore*”³.

Në vijim do të paraqesim disa huazime në leksikun e përgjithshëm të shqipes dhe në shkencat ekzakte, e sidomos të shfaqura si leksik libror, por që përdoren në fushat e mekanikës, ndonëse jo si terma drejtpërdrejt të saj:

a) Në gjuhën e përgjithshme:

abstenim-i (lat. *abstinentia* - përmbajtje, mos marrje pjesë në një votim);

abuzim-i (lat. *abusus* - tepri, shpërdorim) = keqpërdorim, shpërdorim;

adaptim-i (lat. *adaptatio* - përshtatje);

aksesor-i (lat. *accessorium* - shtojcë; pjesë plotësuese ose e dorës së dytë që i shtohet kryesores, shtojcë);

dedikim-i (lat. *dedicatio* - kushtim; përkushtim, të kushtuarit);

edukim-i (lat. *educatio* - edukatë; të edukuarit);

evoluim-i (lat. *evolutio* - zhvillim; ndryshim e zhvillim i ngadalshëm e shkallë-shkallë i diçkaje);

inaugurim-i (lat. *inaugurare* - shuguroj; përuroj; përuhim, ceremoni zyrtare me rastin e fillimit të punës në një objekt me rëndësi ekonomike a shoqërore);

koment-i (lat. *commentarium* - shënime, ditar; shpjegimi e vlerësimi që bëhet rreth një ngjarjeje shoqërore a politike);

rezidencë-a (lat. *residentia* - vendqëndrim, vendbanim; vendi ose ndërtesa ku qëndron në mënyrë të përhershme qeveria, kryetari i shtetit ose një zyrtar i lartë, seli);

spektator-i (lat. *spectator* - shikues; ai që shikon një shfaqje artistike, sportive etj.).

b) Në shkencat ekzakte:

1. Në matematikë

²E. Çabej, *Studime gjuhësore III*, RILINDJA, Prishtinë, 1976.

³Sh. Helmut, *Çështja e zhvillimit të leksikut të shqipes së sotme*, në Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar të gjuhës dhe të kulturës së saj (Tiranë, 2-5 korrik 1982), Tiranë, 1988, f. 329.

Termet e huazuar nga italishtja dhe frëngjishtja në terminologjinë e mekanikës...

binom-i (lat. bi - dy; binominis-shprehje algjebrike, që përbëhet prej dy termash të shkruar me shenjën plus ose minus.

ekuacion-i (lat. aequation - barazim, formulë matematike, që ka dy anë me madhësi e me vlerë të barabartë ndërmjet tyre).

konstante/tja (lat. constants - i qëndrueshëm; madhësi konstante).

koordinatë-a (lat. coordinata - bashkërenditje; madhësi që përcakton me përpikëri vendin ku ndodhet një pikë në rrafsh ose në hapësirë).

minus-i (lat. minus - pa, i vogël; shenja (-) që vihet ndërmjet dy numrave a dy madhësive për të treguar veprimin aritmetik të zbritjes).

numë/-mri (lat. numerus - sasi; nocion themelor i matematikës, që shërben për të shprehur sasinë dhe për të bërë njehsimet).

sinus-i (lat. sinus - një nga funksionet trigonometrike që në rastin e një këndi të ngushtë (të trekëndëshit kënddrejtë) është raporti i katetit përballë me hipotenuzë).

vektor-i (lat. vector - mbartës; segment që ka një drejtim dhe kah të caktuar; madhësi që përveç vlerës numerike, ka edhe një drejtim dhe kah të caktuar në natyrë).

2. Në fizikë:

absorbim-i (lat. absorptia - thitje e gazeve dhe e avullit nga trupat e ngurtë dhe të lëngët); përthithje.

alternator-i (lat. alternator - gjenerator i rrymës alternative (këmbyese), i cili energjinë mekanike e shndërron në energji elektrike.

densitet-i (lat. densus - dendësi).

elasticitet-i (lat. elasticitas - përkulshmëri; përthyerje, epje, vetia që kanë disa trupa të marrin formën e tyre të mëparshme, si të ketë pushuar veprimi i forcës që ua ka prishur këtë formë).

fuzion-i (lat. fusio - shkrirje, tretje; procesi i shkrirjes së bërthamave atomike të lehta në ato më të rënda).

gravitet-i (lat. gravis - i rëndë, gravitas-peshë, rëndim; rëndesë, forca që i tërheq gjithë trupat drejt qendrës së Tokës).

kohezion-i (lat. cohaerere - lidhem ngushtë, ngjitem; forca që mban të bashkuara fort molekulat e një trupi).

2. Kontaktet gjuhësore në bazë të rrethanave gjeografike dhe kushteve historike

Prania e huazimeve në një gjuhë është dëshmi e qartë e kontakteve gjuhësore të vendosura në bazë të rrethanave gjeografike dhe kushteve historike të popujve, gjuhët e të cilave i kanë këto huazime. Procesi i huazimit gjuhësor përbën një dukuri të zakonshme e me karakter pak a shumë universal, prandaj këtij problemi i janë kushtuar një numër i madh punimesh ku janë

dhënë përkufizime e janë bërë klasifikime të huazimeve nga këndvështrime të ndryshme⁴.

Përpara se të fillojmë trajtimin e huazimeve në leksikon e mekanikës po ndalemi në trajtimin që u është bërë huazimeve në studime të ndryshme gjuhësore e terminologjike.

Dalohen dy lloj huazimesh:

- huazim i importuar, kur huazimi është kaq i ngjashëm me modelin saqë folësi vendas mund ta pranojë si të tijin dhe
- huazim i zëvendësuar, kur folësi e riprodhon jo drejt modelin e huaj, duke e zëvendësuar në një formë të ngjashme nga gjuha e tij.

Për sa i përket huazimeve të importuara që në terrenin e huaj i kanë ruajtur të gjitha tiparet origjinale që kanë në gjuhën burimore, me sa duket janë të pakta, sepse rrallë herë ndodh që një huazim të mos pësojë modifikime nga folësit e gjuhës marrëse të cilët vazhdimisht përpiqen të ofrojnë huazim me normat e gjuhës së tyre.

3. Faktorët kryesorë që kanë përcaktuar hyrjen e huazimeve nga italishtja e frëngjishtja në leksikon e mekanikës

Edhe në ditët tona bëhet një luftë e vendosur për t'i nxjerrë jashtë përdorimit fjalët e huaja, në ato raste kur për to kemi fjalë shqipe e më të njohura, që shprehin plotësisht të njëjtin kuptim. Fjala lind e sajohet, ndryshon e zhvillohet, po, më në fund, mund edhe të zhduket fare. Fjalët zhduken bashkë me sende a me nocione të kohës, shumë të tjera zëvendësohen nga fjalë të huazuara prej gjuhësh tjera.

Prof. E. Çabej thotë se “kur të vështrohen marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje në tërësinë e tyre, do të pranohet që roli dhënë i kësaj gjuhe ndaj atyre gjuhëve është çmuar disi nën shkallën reale që i përket... Më anë tjetër elementet e shqipes që kanë shkuar në gjuhët fqinje janë me rëndësi edhe për vetë historinë e kësaj gjuhe, për arsye se ato kanë ruajtur në ato idioma shpesh herë trajta më të vjetra, të cilat në gjuhën vetë që i dha, në shqipen, humbën me kohë dhe u zëvendësuan me të tjera...”⁵.

Dihet se asnjë gjuhë nuk është e izoluar dhe e mbrojtur nga depërtimet e jashtme.

⁴1. A. Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë, 1980. 2. J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006. 3. A. Duro, *Studime gjuhësore*, QSA, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012. 4. V. Dervishi, *Analiza terminologjike e leksikut të mekanikës në gjuhë shqipe*, dis., Tiranë, 1990. 5. S. Pllana, *Leksiku terminologjik bazë i mekanikës në gjuhën shqipe në përfaqje me gjuhën angleze (mbështetur në lëndën e fushave mekanikë teorike dhe mekanikë e aplikuar në makina)*, dis., Tiranë, 2010.

⁵ E. Çabej, *Shqipja dhe gjuhët fqinje*, në *Studime gjuhësore*, IV, Prishtinë, 1977, f. 334.

Termet me burim nga gjuhët italiane dhe frënge në gjuhën shqipe, në terminologjinë e mekanikës, përbëjnë një pjesë relativisht të madhe të të gjithë leksikut të huazuar nga këto dy gjuhë, ku pjesën mbizotëruese e zënë ato italiane, kurse në gjuhën frënge janë të kufizuara.

Faktorët kryesorë që i përcaktuan këto marrëdhënie e huazime ishin ndryshimet e rëndësishme që u bënë në jetën ekonomiko-shoqërore, politike, ideologjike e kulturore të popullit shqiptar në kohën e Rilindjes Kombëtare, të fushave themelore të dijës si nga N. Frashëri⁶: të gjeometrisë: *brinjë, katror, kënd, trekëndësh*; të matematikës: *pjestim, mbledhje, shumëzim* etj. dhe pas shpalljes së Pavarësisë së shtetit shqiptar më 1912. Nevojat e zhvillimit të zejtarisë e të tregtisë, prania e dendur e elementit italian në Shqipëri, administrimi ushtarak i Korçës me rrethinë prej vitit 1917 deri më 1921, liceu i Korçës, ku mësimet zhvilloheshin në gjuhën frënge, që nga viti 1917 deri me pushtimin e Shqipërisë nga forcat fashiste italiane, prania e shumë ndërmarrjeve italiane e frënge që shfrytëzonin pasuritë e tokës shqiptare, ndryshuan strukturën e popullsisë duke e vënë në lidhje të gjalla me jetën e me kulturën e shprehur me gjuhë italiane e frënge. Kjo gjendje u pasqyrua me të madhe në leksikun e shqipes, ku huazimet nga italishtja morën numër më të madh sesa nga frëngjishtja. Një dukuri e tillë është e arsyeshme duke pasur parasysh fqinjësinë e popullit shqiptar me Italinë.

Qytetërimi italian e frëng është shfaqur në forma të ndryshme; në fushën e natyrës dhe të mjedisit jetësor, në sferën politiko-shoqërore, në lëmin e teknikës, të shkencave ekzakte, në atë të vendbanimit dhe të shtëpisë, në sferën e shtypit, të letërsisë e të gjuhësisë, të drejtësisë, të tregtisë e financave, të ekonomisë, të bujqësisë, në fushën psiko-pedagogjike, shkollore e edukative, të armëve e të jetës ushtarake, të pjesëve të automobilite e të makinave industriale, në sferën e komunikacionit e të trafikut, më në fund në sferën e emërtimeve të nocioneve abstrakte e të terminologjisë tekniko-shkencore⁷.

Duke i studiuar huazimet nga gjuha italiane dhe frënge në terminologjinë e mekanikës, në rrafshin e prejardhjes së tyre, rezultojnë ky klasifikim:

1) Terma të huazuar nga gjuha italiane. Të gjithë termat nga italishtja kanë hyrë në terminologjinë e mekanikës në mënyrë të drejtpërdrejt. Huazimet nga gjuha italiane përbëjnë grupin më të madh të huazimeve të terminologjisë së mekanikës, në periudhën e para çlirimit⁸. Ndikim të madh ushtruan shkollat

⁶ H. Pasho, *Leksiku terminologjik në veprën mësimore të N. Frashërit*, në SF. 1-2, 1991.

⁷ F. Leka, *Terminologjia tekniko-shkencore dhe gjuha e sotme letrare shqipe në Studime për leksikun dhe për formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, III, Tiranë, 1989, f. 645.

⁸ V. Dervishi, *Analiza terminologjike e leksikut të mekanikës në gjuhën shqipe*, dis., Tiranë, 1990, f. 174.

profesionale italiane, të cilat u përhapën në qytetet kryesore të vendit (Shkodër, Berat, Korçë e Gjirokastrë).

2) Termat e huazuar nga gjuha frënge. Termat nga frëngjishtja, në terminologjinë e mekanikës, kanë hyrë në gjuhën shqipe në dy mënyra: drejtpërsëdrejti, p.sh.: termat *cilindër*, *cilindrim*, *kamion*, *kurbalinë* etj., dhe në mënyrë të tërthortë, p.sh.: termat *bulon*, *fonderi*, *ingranazh*, *kremalier*, *krik*, *pinjon*, *shevron*, *volan* etj.

4. Puna për zëvendësimin e disa termave të huaj me fjalë nga leksiku i shqipes

Termat e huazuar janë dy llojesh: *terma të huaj ndërkombëtarë* e *terma të huaj jondërkombëtarë*. Në fjalorët terminologjikë dhe në literaturën e inxhinierisë mekanike (“*Fjalor i termave themelorë të mekanikës*”, Tiranë, 2002 dhe “*Fjalor terminologjisë tekniko-shkencore, Terminologjia e mekanikës*” (shqip-serbokroatisht-rusisht-frëngjisht), Prishtinë, 1970) janë pasqyruar terma të cilët mund të ndahen në tri grupe:

Në grupin e parë janë pasqyruar termat, por nuk kanë zënë vend në ligjërimin praktik, ndonëse janë menduar si të përshtatshme, meqë termat përkatës diferencojnë konceptet, si: *ferrim* për *abrazion*, *fikatës* për *amortizator*, *brenë* për *biellë-a*, *shilor-i* për *bilancier-i*, *rrotë dhëmbëzore*, për *ingranazh*, *ngërthim* për *ingranim*, *qukosje* për *pitëng-u*, *petunazë-a* për *rondele-ja*, *gishtak-u* për *spinot-i* etj.

Në grupin e dytë pasqyrohen termat që kanë zënë vend në leksikun e shqipes, si: *përthithës-i*-*absorbues-i*, *përshpejtim-i*-*akselerim-i*, *baraspeshim-i* - *balancim-i*, *nyjtesë-a* - *çernierë-a*, *përmasë-a* - *dimension-i*, *rrotë gëdhendëse* - *dollbjak-u*, *jashtëqendërsi-a* - *ekscentricitet-i*, *baraspeshë-a* - *ekuilibër-i*, *lakore* - *kurbë-a*, *lustrim-i* - *polirim-i*, *bulon pa kokë* - *prixhonier-i*, *gjysmëbosht-i* - *semiaks-i*, *tërheqës-i* - *tirant-i*, *rrotullime-t* - *xhiro-t* (e motorit) etj., dhe grupi i tretë përbën shkallë ndërmjetëse, si: *përshpejtues-i* - *akselerator-i*, *buzinë-a* - *bordurë-a*, *qendërzim-i* - *centrim-i*, *flutur-a* - *farfallë-a*, *fijëz-a* - *fibër-a*, *përqendrim-i* - *koncentrim-i*, *lyrës-i* - *lubrifikant-i*, *bërrylaku-u* - *manivelë-a*, *ndeshjepritës-i* - *parakolp-i*, *trysni-a* - *presion-i*, *shpojsë-a* - *punto-ja*, *ndemje-a* - *sforcim-i*, *mbështetës-i* - *suporti-i*, *kresë motori* - *testato-ja*, *tërheqës-i* - *tirant-i*, *tejçim-i* - *transmetim-i*, *dridhor-i* - *vibrator-i* etj.

Për nevoja të plotësimit të terminologjisë bazë të mekanikës, mund të pranohen dy lloj huazimesh:

1) Huazime të brendshme ose brendagjuhësore që vijnë brendapërbrenda gjuhës nga terminologjitë e fushave të tjera;

2) Huazime të jashtme, të cilat vijnë nga terminologjitë e gjuhëve të huaja.

Këtu do të shikojmë atë pjesë të huazimeve, të cilat në terminologjinë e mekanikës vijnë nga terminologjitë e gjuhëve italiane dhe frënge.

Termet e huazuar nga italishtja dhe frëngjishtja në terminologjinë e mekanikës...

Për të nxjerrë më në pah këto veçori, që vihen re në të dyja gjuhët, mund të sjellim një varg shembujsh, të cilët evidentojnë shkallën e huazimit të leksikut të mekanikës në gjuhën shqipe, sidomos me prejardhje nga italishtja, por edhe nga gjuhë të tjera. Për këtë po i paraqesim shembujt nga e kundërta, duke dhënë të parën gjuhën shqipe dhe të dytën-italishten, si edhe frëngjishten:

Në shqipe

(Të prejardhur nga ital. ose përmes saj)

balest/ër-ra
biell/ë-a
bilancier-i
bokol-a
çernier/ë-a
filet/ë-a
filetim-i
fren-i
friksion-i
kaçavidh/ë-a
kapriat/ë-a
kushinet/ë-a
prixhionier-i
pulexh/ë-a
spinot-i
tambur-i
torno-ja
tornoj
tornim-i
trapano-ja
xhunt/ë-a

Në italishte

balestra
biella
ilanciere
boccola
cerniera
filetto
filettatura
freno
frizione
cacciavite
capriata
cuscinetto
prigioniera
puleggia
spinotto
tamburo
tornio
tornare
tornatura
trapano
giunto

Në shqipe

(Të prejardhur nga fr. ose përmes saj)

kamion-i
bulon-i
ingranazh-i
kremalier/ë
krik-u
frez/ë-a
pinion -i
shevron-e
volan-i

Në frëngjishte

camion
boulon
engranage
crémaillère
cric
fraise
pinion
chevron
volant

Nga vëzhgimet që kemi mundur të bëjmë kemi arritur në përfundimin që, ndërsa në pjesën dërrmuese termat në shqipë me prejardhje nga italishtja i përgjigjen në anglishte termave anglezë amtarë, termat e huaj të anglishtes të fushës në fjalë dalin pak a shumë si ndërkombëtarizma, të cilët nga ana e ndërtimit përbëhen nga elemente greko-latine. Ndikimi i gjuhës angleze në terminologjinë e mekanikës, vitet e fundit, sidomos pas vitit 1990 ndihet edhe pesha specifike e gjuhë angleze.

Më poshtë po japim disa shembuj, me termin e parë në anglishte, duke i përqsaur me shqipën dhe me italishten. Këtu përfshihen edhe terma që kanë përshtatje vetëm nga ana fonetike (fonematike) dhe morfologjike (në vartësi të natyrës së gjuhës), si, p.sh. *machine* (angl.) - *makinë-a* (shq.) - *macchina* (it.).

Anglisht	Shqip	Italisht
<i>abrasion</i>	<i>abrazion-i</i>	<i>abrazione</i>
<i>acceleration</i>	<i>akselerim-i</i>	<i>accelerazione</i>
<i>accelerator</i>	<i>akselerator-i</i>	<i>acceleratore</i>
<i>accessory</i>	<i>aksesor-i</i>	<i>accessore</i>
<i>axis</i>	<i>aks-i</i>	<i>asse</i>
<i>converter</i>	<i>konvertor-i</i>	<i>convertitore</i>
<i>corrosion</i>	<i>korrozion-i</i>	<i>corrosione</i>
<i>cylinder</i>	<i>cilind/ër-ri</i>	<i>cilindro</i>
<i>differential</i>	<i>diferencial</i>	<i>differenziale</i>
<i>disk</i>	<i>disk-u</i>	<i>disco</i>
<i>elevator</i>	<i>elevator-i</i>	<i>elevatore</i>
<i>equilibrium</i>	<i>ekuilibër</i>	<i>equilibrio</i>
<i>fraction</i>	<i>fraksion-i</i>	<i>frazione</i>
<i>gravitation</i>	<i>gravitacion-i</i>	<i>gravitazione</i>
<i>gravity</i>	<i>gravitet-i</i>	<i>gravità</i>
<i>instrument</i>	<i>instrument-i</i>	<i>strumento</i>
<i>limit</i>	<i>limit-i</i>	<i>limite</i>
<i>lubrication</i>	<i>lubrifikim-i</i>	<i>lubrificazione</i>
<i>mechanism</i>	<i>mekaniz/ëm-mi</i>	<i>meccanismo</i>
<i>metal</i>	<i>metal-i</i>	<i>metallo</i>
<i>piston</i>	<i>piston-i</i>	<i>pistone</i>
<i>radial</i>	<i>radial</i>	<i>radiale</i>
<i>separator</i>	<i>separator-i</i>	<i>seperatore</i>
<i>transmission</i>	<i>transmision-i</i>	<i>trasmissione</i>
<i>tube</i>	<i>tub-i</i>	<i>tubo</i>

Terminologjia e inxhinierisë mekanike, si terminologji e një fushe me shtrirje të gjerë në praktikë, lidhet me jetën e përditshme të pedagogëve nëpër shkolla të mesme dhe të profesorëve nëpër universitetet shqiptare, njerëzve me

problemet e kohës që kanë, duhet t'i ndihmojë në komunikim, kryesisht specialistëve për bashkëbisedime dhe veprime të sakta.

Mund të thuhet se terminologjia e inxhinierisë mekanike është e konsoliduar deri diku, por duhet të vazhdojë puna për plotësimin dhe ripunimin e fjalorëve për fusha të ngushta të dijes për të përmirësuar mangësitë e bartura, por, sidomos për të zgjidhur problemet e kohës në këtë terminologji.

Përfundim

Ndikimi i latinishtes dhe i gjuhëve romane në shqipe ka qenë i madh, por nganjëherë gjurmët e tyre janë mbivlerësuar.

Faktet gjuhësore tregojnë se shqipja, për njërin apo tjetrin arsye, për njërin apo tjetrin status, ka marrë shumë fjalë prej gjuhëve romane.

Në realitet shqipja u rezistoi ndikimit të fortë të latinishtes dhe gjuhëve romane dhe nuk u asimilua prej tyre.

Fjalët e huazuara romane të shqipes përshtaten në pikëpamje fonologjike sipas parimeve dhe shprehive fonologjike të shqipes.

Fonemat romane, të italishtes e frëngjishtes, ndërrojnë e modifikohen në gjuhën tonë nga shqiptimi dhe nga drejtshkrimi. Shumica e huazimeve italiane kanë depërtuar në shqipe drejtpërsëdrejti nga gjuha e folur, ndërsa huazimet frënge kanë depërtuar më tepër në bazë të shkrimeve dhe trajtës së shkruar drejtshkrimore.

Një numër i këtyre huazimeve është futur nga mjeshtërit dhe inxhinierët, e fushave të ndryshme teknike, për të shprehur e për të emërtuar vegla, pajisje ose objekte të futura në vendin tonë si dhe për nocione të ndryshme shkencore e të teknikës bashkëkohore.

Në dy fjalorët terminologjikë, të botuar në kohë të ndryshme, "*Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore, Terminologjia e mekanikës*" (shqip-serbokroatisht-rusisht-frëngjisht) (Prishtinë, 1970) dhe "*Fjalor i termave themelore të mekanikës*" (Tiranë, 2002) kanë gjetur pasqyrime dhe përmirësimet e saktësimet që janë bërë për formën e termit të shqipëruar apo për zgjedhjen e termit më të përshtatshëm midis dy termave.

Dihet se fjalët e huaja e prishin gjuhën, kur pranohen e përdoren pa nevojë. Fjalët e huaja duhet të përdoren në ato raste kur sjellin një kuptim të ri, një nuancë kuptimore të re, etj., që nuk mund ta shprehim me mjetet e vetë shqipes.

Vetëm për huazimet më konkrete, si p.sh. emërtimet e veglave, pajisjeve e objekteve të importuara rishtas, mund të flitet si për një shtojcë të vokabularit ekzistues.

Shumë fjalë të huazuara, që dukeshin të pamënjanueshme, janë përvetësuar si kalke, një numër i madh huazimesh romane sot ose janë zëvendësuar, ose janë bërë të zëvendësueshme nga fjalët shqipe.

BIBLIOGRAFI

- A. Duro (1984), *Fjala shqipe në terminologjinë e mekanikës*, në SF, 1984/4.
- A. Duro (2002), *Terminologjia si sistem*, Tiranë, 2002.
- A. Duro (2009), *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe (në rrafshin e formës dhe të përmbajtjes)*, QSA, Shtëpia botuese “Fan Noli”, Tiranë, 2009.
- A. Duro (2012), *Studime gjuhësore*, QSA Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012.
- Dh. Mihali (1974), *Akset dhe boshtet*, Tiranë, 1974.
- Dh. Mihali (1977), *Rrotat e dhëmbëzuara (Gjeometria e tyre)*, Tiranë, 1977.
- Dh. Mihali, N. Zaka (1974), *Toleranca e matje teknike*, Pjesa II, Dispensa I, Tiranë, 1974.
- Dh. Olldashi (1983), *Fjalor politeknik frëngjisht-shqip*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1983.
- F. Beer, etj. (2004), *Vector Mechanics for Engineers Statics*, McGraw-Hill, New York, 2004.
- Fjalor i termave themelorë të mekanikës*, Tiranë, 2002.
- Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore, Terminologjia e mekanikës (shqip-serbokroatisht-rusisht-frëngjisht)*, Prishtinë, 1970.
- G. Pllana, S. Pllana (2013), *About some manifestations of antonymy and synonymy in the terminology of economics*, 2nd Symposium of Social Sciences and Humanities PhD Students "Education Culture and Society - Nowadays Challenges", in Wrocław on 14th-17th of October 2013 at the University of Wrocław, Poland.
- H. Buckch (1976), *Getriebewörterbuch- Dictionary of mechanisms*, Bauverlag GmbH-Wiesbaden und Berlin, 1976.
- H. Lacaj & F. Fishta (1980), *Fjalor latinisht-shqip*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
- H. Voci (1980), *Fjalor italisht-shqip*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1980.
- I. Jashari, G. Pllana (1994), *Detalet e makinave – Transmisionet me rripa dhe zinxhirë*, Prishtinë, 1994.
- J. Thomai (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
- M. Bejta (1985), *Fjalor frëngjisht-shqip*, ETMM, Prishtinë, 1985.
- M. Domi (1988), *Probleme të historisë së formimit të gjuhës shqipe*, në Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar të gjuhës dhe të kulturës së saj, (Tiranë, 2-5 korrik 1982), Tiranë, 1988.
- M. Gjonaj, etj. (1990), *Mekanizim*, Tiranë, 1990.
- N. Çabej (1980), *Nga historia e zhvillimit të shkencës shqiptare*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1980.
- Sh. Helmut (1988), *Çështja e zhvillimit të leksikut të shqipes së sotme*, në Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar të gjuhës dhe të kulturës së saj (Tiranë, 2-5 korrik 1982), Tiranë, 1988.